

KARTELË INFORMATIVE

AL011099

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| 1. Emri i shërbimit | Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni | | | |
| 2. Cili është qëllimi i shërbimit? | Aplikanti mund ta përdorë këtë shërbim për të pasur mundësinë e zgjatjes së afatit për plotësimin e dokumentacionit nëse Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka lëshuar njoftim në lidhje me aplikimin. | | | |
| 3. Çfarë ofron ky shërbim? | Gjatë ekzaminimit të elementëve formalë të një aplikimi për regjistrim për tregues gjeografik, nëse Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale vëren se nuk janë përfshirë të gjithë elementët formalë të parashikuar nga neni 182 i Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar dhe të rregullores së dalë në zbatim të tij, njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda dy muajve nga data e njoftimit. Me anë të këtij shërbimi, aplikanti mund të kërkojë zgjatjen deri në dy muaj shtesë të periudhës për paraqitjen e plotësimeve. | | | |
| 4. A jam përfutues? | Përfutuesi i shërbimit është një "grup" i organizuar në formën e shoqatës, e cila pavarësisht nga forma e saj ligjore përbëhet kryesisht nga prodhuesit apo përpunuesit që punojnë me të njëjtin produkt. Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme: a) personi është i vetmi prodhues i gatshëm të paraqesë një kërkesë; b) për sa u përket emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje. | | | |
| 5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim? | Nr | Lloji | Dokumenti lëshohet nga: | Dorëzohet në sportel nga aplikanti? |
| | 1 | Formular aplikimi "Për zgjatje afati për plotësim dokumentacioni (tregues gjeografik)" | Aplikanti | Po |
| | 2 | Mandat pagesa e tarifës përkatëse | Banke | Po |
| 6. Ku mund të aplikoj? | Zyrat pritëse | Qyteti | Adresa | Orari |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) | Tiranë | Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Usharakëve, Tirana | E hëna- e enjte: 08:00 - 16:30 Të premten: 08:00-14:00. |
| 7. A është ky shërbim online? | Niveli 1 | Niveli 2 | Niveli 3 | Niveli 4 |
| | Ofrohet informacion mbi shërbimin | Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit | Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online | Shërbimi ofrohet tërësisht online |
| | <input checked="" type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit? | Tarifa bazë | Tarifa shtesë | Tarifa Online | Mënyra e pagesës |
| | 2000 lekë | Nuk ka | | Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit |
| 9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin? | 1 muaj | | | |
| 10. Çfarë përfiton? | Njoftim | | | |
| 11. Ç'afat vlefshmërie ka? | Pa afat | | | |
| 12. Ku e marr? | Në sportele <input checked="" type="checkbox"/> | Me postë <input checked="" type="checkbox"/> | E-albania <input type="checkbox"/> | Me e-mail <input type="checkbox"/> |
| 13. Cili është institucioni përgjegjës? | Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, DPPI | | | |
| 14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim? | Kontakto në: | | Orari | |
| | E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118 | | Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00 | |
| 15. Nëse kam ankesë, si të veproj? | Në sportele <input checked="" type="checkbox"/> | Me postë <input checked="" type="checkbox"/> | Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/> | Me e-mail <input type="checkbox"/> |
| | Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al | | <input checked="" type="checkbox"/> | |
| 16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi? | Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative. VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, i ndryshuar"; | | | |